

NË EMËR TË POPULLIT

GYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti për Krime të rënda-Divizioni penal, si gjykatë penale e shkallës së parë, në trupin gjykues të përbërë prej : Aziz Shaqirit – kryetar i trupit si dhe Veli Kryeziu dhe Ramiz Azizi që të dy anëtar të trupit gjykues, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale të akuzuarit B. A., për shkak të veprës penale **blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike nga neni 229 paragrafi 2** të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KPK-s), të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av..., sipas aktakuzës së Prokurisë së Qarkut në Gjilan tani të transformuar në prokurori Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të rënda PP.nr. 324/2011 të datës 27 dhjetor të vitit 2011, të cilin e përfaqësoj prokurori i shtetit Arben Kadriu, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të serishëm, verbal dhe publik më 18 korrik të vitit 2016 mori dhe në prani të prokurorit të shtetit dhe të të akuzuarit me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare, në të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I. I akuzuari B.A me pseudonimin, nga babi ...dhe e ëma– e lindur T....., i lindur mënë Gj., me adresë rruga martuar, babai i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme , me gjendje të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, të pagykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij i tërhiqet vërejtja se është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën për çdo ndërrim eventual të vendbanimit përkatësisht të vendqëndrimit të tij nën kërcënim të pasojave ligjore me lëshim të urdhër arrestit e nëse plotësohen kushtet ligjore edhe të letër rreshtimit,

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse më datën ..., rreth orës ... minuta, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofertë për shitje ka poseduar substanca të cilat janë shpallur si të rrezikshme, të cilat nga DHTN në Gjilan, gjatë kontrollimit të shtëpisë së të pandehurit në Gj., rruga “ ... “ ..., janë gjetur ... paketime – qese me substancë narkotike të llojit marhuanë me peshë prej ...gram si dhe një qese me fara të të njëjtit lloj me peshë prej ... gram, një peshore dhe një enë e plastikës për kultivimin e marhuanës, të cilat edhe janë sekuestruar nga ana e Policisë së Kosovës – Stacioni Policor në Gjilan,

- me çka ka kryer veprë penale **blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike nga neni 229 paragrafi 1 të KPK-s.**

Gjykata në bazë të dispozitave të cituara, nenit 3, 6, 15, 34, 36, 38, 64, 65 paragrafi 1 të KPK-s, nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Kodit penal të republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KPRK-s), si dhe nenit 365 të Kodit të procedurës penale (në tekstin e mëtutjeshëm KPP-s), të akuzuarit në fjalë,

I SHQIPTON DËNIME KUMULATIVE

Edhe atë:

- **Dënim me burgim** në kohëzgjatje prej një (1) viti, të cilin detyrohet të filloj ta mbaj, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi të plotfuqishëm, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm dhe

-**Dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) Euro**, të cilën shumë detyrohet ta përmbush në afat prej dy muajve, duke filluar nga dita e pranimit të aktgjykimit të plotfuqishëm lidhur me këtë çështje penale, në të kundërtën dënimi i tillë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10)ditëve, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

II. Të akuzuarti në fjalë në kuptim të nenit 60 dhe 229 paragrafi 5 të KPK-s,i shqiptohet dënimi plotësues – konfiskimi i substancës narkotike të llojit marhuanë edhe atë 44 paketime – qese me peshë prej 86 gramëve, një qese me fara të narkotikut të llojit marhuanë me peshë prej 4 gramëve, një peshore por edhe një enë – akuarium plastik për kultivimin e bimës së marhuanës, të cilat do të shkatërrohen nga komisioni përkatës i formuar nga kryetari i kësaj gjykate, duke u konstatuar me procesverbal nga ana e shërbimit për ekzekutimin e sanksioneve penale të kësaj gjykate. Pala e dëmtuar KEDS distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesë pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridik.

III. DETYROHET i akuzuari në fjalë që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej njëqind (100) Euro, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Organi i ndjekjes penale kundër të akuzuarit në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar mirë, se i njëjti ka kryer veprën penale lëndore nga neni 229 paragrafi 2 të KPK-s.

Gjykata Themelore në Gjilan me aktgjykimin P.nr. 97/2012 e ka shpallur të akuzuarin fajtor për veprën penale nga neni 275 paragrafi 1 të KPRK-s duke i shqiptuar dënime kumulative edhe atë me burgim në kohëzgjatje prej tre muajve di dhe dënim me gjobë prej 200 Euro, si dhe dënimin plotësues lidhur me konfiskimin e sendeve përkatëse.

Gjykata e Apelit me aktvendim PAKR. Nr. 242/2013 të datës 14.02 2014 ka aprovuar ankesën e Prokurorisë Themelore duke e anuluar aktgjykimin e ankimuar dhe kthyer lëndën në rivendosje, me arsyetim se aktgjykimi lëndor është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale meqë dispozitivi është në kundërshtim me brendinë e tij, faktet vendimtare si dhe arsyetimin, pasi që ditën kritike tek i akuzuari janë gjetur 44 qese të paketuara me substancë narkotike të llojit marhuanë, të paketuara në çdo qese me peshë[prej ...gram apo sasi e përgjithshme prej ...gramëve, të përgatitura për shitje. Në këtë aktvendim janë dhënë edhe arsytet tjera për anulimin e aktgjykimi, edhe pse nga gjykata e shkallës parë konsiderohen jo relevante, meqë mjaftojnë arsytet e

lartcekura, sepse gjykata e shkallës parë ka autorizim ligjor që ta cilësojë juridikisht ndryshe veprën penale, mirëpo sipas parimit të akuzarit në përshkrimin faktik të veprës penale nuk ka autorizim të intervenoj në mënyrë përmbajtësore, meqë këtë përzjerje në kompetencë të organit të ndjekjes penale nuk ia lejon ligji.

Gjykata pas pranimit të lëndës penale në afat të arsyeshëm ka caktuar seancën e rigjykimit të kësaj lënde duke i ftuar palët dhe pjesëmarrësit tjerë sipas aktit akuzës. Prokurori i shtetit ka bërë përmirësimet përkatëse në aktin akuzës edhe atë : në rreshtin e parafundit të përshkrimit faktik ka bërë përmirësimin ashtu që pas fjalëve “ ... “ shtohen fjalët “ një peshore dhe një enë e plastikës për kultivimin e marihuanës, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar kurse sa i përket kualifikimit juridik në vend të paragrafit 2 të nenit 229 të KPK-s duhet të pëjete paragrafi 1”.

Kryetari i trupit gjykues e ka njoftuar të akuzuarin me të drejtat e tij, ndër të tjera edhe lidhur me pranimin e fajësisë e cila rrethanë do të konsiderohet si rrethanë lehtësuese por edhe lidhur me pasojën e pranimit të fajësisë edhe atë në prani të mbrojtësit të tij, të cilin nuk e kundërshtuar që t'i jap mbrojtje profesionale. I akuzuari pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas përshkrimit faktik të veprës penale të përmirësuar por edhe sipas veprës penale të rikualifikuar në aspektin juridik, e këtë nuk e ka kundërshtuar as mbrojtësi i tij e as prokurori i shtetit si përfaqësues i aktit akuzues. Andaj trupi gjykues pasi që konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 326 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 dhe neni 248 të KPRK-s ka marr kurse kryetari i trupit gjykues ka komunikuar aktvendimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në fjalë, me arsyetim se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 326 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 dhe neni 248 të KPRK-s, të cilin pasi që ka konstatuar se nuk e kundërshtojnë palët, ka vazhduar seancën e rigjykimit me fjalët përfundimtare të palëve si në vijim.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë akuzës së përmirësuar dhe veprës penale të rikualifikuar, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe dënoj sipas Kodit Penal, e me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, por edhe pranimin e fajësisë, pendimin dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të tilla , duke propozuar edhe konfiskimin e substancës narkotike.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.gjatë fjalës përfundimtare deklaroj se gjykata me rastin e vendosjes duhet t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese edhe atë pranimin e fajësisë, moshën relativisht të re të të akuzuarit,, premtimin se nuk do të kryej vepra penale në të[ardhmen, pendimin e thellë dhe të sinqert, duke ia shqiptuar një dënim të zbutur me të cilin me siguri do të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari deklaroj se e mbështet mbrojtjen e mbrojtësit të tij, se ka tri vite që nuk konsumon substancë narkotike të llojit marihuanë por as të llojeve tjera, se ka vendos të jetoj me djersën e tij duke punuar me mëditje me që ka vërejt se konsumimi i substancës narkotike është i dëmshëm për shëndetin e tij por edhe shitja apo shpërndarja e tij është e dëmshme për një rreth më të “gjon” dhe se këto kritere kanë qenë kritere vendosë se që ma mos me konsumuar por edhe mos me shit apo shpërndarë substancën narkotike.

Gjykata për mos me e mbështet aktgjykimin vetëm në pranimin e fajësisë së të akuzuarit ka vendos që të vlerësojë në kuptim të nenit 361 të KPP-s edhe provat tjera në shkresa të lëndës edhe atë duke lexuar vërtetimin mbi sekuestrimin e substancës narkotike të llojit marihuanë prej ...gram (vërejtje e jonë duke përfshirë edhe ... gram në një qese me fara të bimës së marihuanë), një peshore si dhe të një akuariumi plastik për kultivimin e bimës,

raportin mbi testin fushor nga drejtoria e hetimeve të trafikimit të narkotikëve të datës ..., sipas të cilit është konstatuar se kemi të bëjmë me narkotikë të llojit marihuanë me peshë prej ... gram, edhe atë ... gram të substancës narkotike plus ... gram të farave të kësaj substance narkotike, procesverbali mbi bastisjen e banesës së të akuzuarit, fotodokumentacionit të sendeve të sekuestruara dhe vendit ku janë gjetur dhe sekuestruar si dhe të akteve tjera shkresore, duke vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga gjendja faktike rezulton elementi subjektiv i cili konsiston në dashje meqë i akuzuari me dashje ka poseduar ... qese marihuanë – substancë e rrezikshme dhe e ndaluar përkatësisht me peshë të përgjithshme prej ... gram plus ... gram fara të kësaj bime të vendosura në një qese, por edhe elementet objektive pasi që i akuzuari substancën narkotike lëndore e ka ndarë në ... qese me peshë të përgjithshme prej ... gram plus ... gram fara të kësaj bime, të dedikuara për shitje, e këtë e ka pranuar edhe vet i akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata nuk ka gjetur ndonjë provë sipas të cilës mund të vërtetohet paaftësia mendore e as ajo esencialisht e zvogëluar, andaj edhe ka vërtetuar se i akuzuari është penalisht përgjegjës për veprimet inkriminuese lëndore, pasi që i njëjti nga gjendja e vërtetuar rezulton se i ka kuptuar veprimet e tij inkriminuese dhe se ka pasur mundësi që të përmbahet nga veprimet e tij inkriminuese lëndore.

Gjykata duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë të gjitha tiparet e veprës penale nga neni 229 paragrafi 1 të KPK-s, andaj edhe ka vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 64 të KPK-s si dhe nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-s si dispozitë më e favorshme për të akuzuarin, edhe atë : si rrethana lehtësuese ka gjetur : pranimin e fajësisë pa hezitim, pendimin e sinqertë për veprimet inkriminuese të tij, premtimin se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet inkriminuese të këtij lloji dhe të ngjashme pasi që ka më tepër se tri vite që më nuk konsumon narkotikë, gjendjen familjare të tij pasi që është i martuar dhe mbajtës i vetëm i familjes duke përfshirë bashkëshorten e tij dhe fëmijën e mitur, se është i pagjykuar për natyrë të njëjtë ose të ngjashme të veprave penale me veprën lëndore penale, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Andaj duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar por edhe rrethanat lehtësuese të lartcekura, në kuptim të nenit 64 dhe 67 të KPK-s por edhe nenin 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1,3 të KPRK-s si dispozitë më e favorshme për të akuzuarin, gjykata është bindur se edhe me dënimet kumulative të lartcekura mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit edhe atë me minimumin e dënimit me burgim prej një viti si dhe me dënimin me gjobë prej 200 Euro, dhe se me këto dënime në kuptim të nenit 34 të KPK-s mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit, duke parandaluar të akuzuarin që në të ardhmen mos të kryej vepra penale por dhe se do të disiplinohen edhe qytetarët tjerë potencial që mos të kryejnë vepra të natyrës së njëjtë apo të ngjashme.

Në kuptim të nenit 60 dhe nenit 229 paragrafi 5 të KPK-s të akuzuarit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues si në dispozitiv.

Në kuptim të nenit 368 të KPP-s palët pas shpalljes së aktgjykimit janë njoftuar me të drejtën në ankesë.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda
Divizioni Penal PKR.nr. 67/2014,më dt. 18 korrik të vitit 2016**

**Sekretarja juridike,
gjkues ,
Kadrije Zymberi**

**Kryetari i trupit

Aziz Shaqiri**

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi të ekzemplarit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.